

BIRN

31 JUL 2024

Nr.pt. 6592



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINE

Nr.No. 031-23975125

Data-Date

31.07.2024

Qendra Kline

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES

KOMUNA E KLINËS dhe

RRJETI BALLKANIK PËR GAZETARI HULUMTUESE



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SOC



Sweden
Sverige



HELVETAS

Palët nënshkruese

1. Komuna e Klinës, me adresë, Rr “Abedin Rexha”, nr.31, e përfaqësuar nga z. Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës

2. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, BIRN Kosova, me adresë në rrugën “Afrim Zhitia Nr.7” Prishtinë 10000, Kosovë, e përfaqësuar nga znjsh. Dorentina Kastrati, menaxhere e projektit për Auditim Social në BIRN

Në kontekst të projektit për Auditim Social, Komuna e Klinës dhe organizata joqeveritare BIRN Kosova, merren vesh sipas pikave në vijim:

Neni 1

Baza ligjore

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, rregulloret e brendshme të komunës dhe statutin e OJQ BIRN, palët dakordohen që në mirëbesim të implementojnë zotimet e dakorduara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 2

Qëllimi

Me qëllim të rritjes së angazhimit të qytetarëve, rritjes së transparencës dhe llogaridhëniec në nivel lokal në implementimin e projekteve infrastrukturore dhe mbikëqyrjes qytetare, dhe promovimit të hapësirës së dialogut publik, palët dakordohen t'i hapin rrugë themelimit të “Ekipit të Auditimit Social” në projektet **“Rregullimi i shtratit të lumenit Klinë”** dhe **“Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimin të ujit të pijes në Klinë”**¹.

Neni 3

Obligimet e BIRN

1. Bazuar në metodologjinë e dakorduar, OJQ BIRN Kosova do të përzgjedhë ekipin multidisiplinar të Auditimit Social në Komunën e Klinës:
 - 1.1. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve, BIRN Kosova do të ofrojë një program trajnimi për qytetarët që do të jenë pjesë e ekipit të Auditimit Social;
 - 1.2. Me qëllim të garantimit të një procesi profesional të Auditimit Social, BIRN Kosova do të fasilitoje të gjithë procesin përmes ofrimit të mentorimit profesional dhe asistencës teknike për ekipin e themeluar;
 - 1.3. BIRN Kosova do të shërbejë si lehtësues i komunikimit në mes komunës dhe ekipit të Auditimit Social me qëllim të koordinimit dhe dokumentimit të aktiviteteve të grupit;

¹ Projekte kapitale të finançuara nga Granti i Performancës Komunale.



Co-funded by
the European Union




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS





1.4. BIRN Kosova do të ofrojë asistencë për ekipin e Auditimit Social me qëllim përgatitjen e raportit final dhe raporteve të tjera gjatë procesit për Komunën e Klinës.

1.5. BIRN Kosova do të sigurohet që materialet e mbledhura nga procesi i Auditimit Social të trajtohen sipas legjisacionit në fuqi.

Neni 3

Obligimet e komunës

1. Komuna e Klinës ka për obligim të:

- 2.1. Sigurojë qasje në dokumentacionet e nevojshme për të kryer procesin e "Auditimit Social";
- 2.2. Ofrojë mundësi që pjesëtarët e Auditimit Social të takojnë zyrtarët përgjegjës të përfshirë në implementimin e projektit në fjalë;
- 2.3. Sigurojë qasje të papenguar në hapësirat e realizimit të Auditimit Social.

Neni 4

Mbështetja financiare

Mbështetja që ofrohet nga BIRN Kosova përgjatë tërë procesit të Auditimit Social mbulohet nga mbështetja e projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia, zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation Kosovo.

Neni 5

Mbikëqyrja e realizimit të marrëveshjes

Organ përgjegjës për mbikëqyrjen dhe realizimin e kësaj Marrëveshje është Komuna e Klinës.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje origjinale, dhe secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

2. Periudha e implementimit të Auditimi Social, gjatë të cilit është i nevojshëm bashkëpunimi që është subjekt i kësaj marrëveshje, zgjatë nga muaji korrik 2024 deri 2024.

Dorentina Kastrati
Menaxhere e projektit
Rjet Baneve, BIRN

Klinë, dt. _____

Zenun Eleza
Kryetar, Komuna e Klinës

Klinë, dt. _____



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

